



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për Tremujorin e Tretë 2019

Oda e Mjekëve të Kosovës



Tetor2019

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për Tremujorin e Tretë 2019.....	1
1. Anëtarësimi	3
2. Mbikëqyrja etiko-profesionale	4
3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	5
4. Licencimet.....	5
5. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për OPSH-të	6
6. Raporti financiar.....	6
6.1 Gjendja financiare – 30 shtator 2019.....	6
7. Këshilli Drejtues.....	7
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	8
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së:	9
10. Aktivitete të tjera	9
10.1 Shërbimi profesional	9
10.2 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë.....	9
10.3 Auditimi financiar dhe funksional.....	10
10.4 Marrëveshjet.....	10
10.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	11
10.6 Marrëdhënie ndërkombëtare.....	11
11. Plani i veprimit për 2019.....	12
10.1 Projektet afatgjata.....	12
10.2 Aktivitetet kyçe për T4/2019.....	12

1. Anëtarësimi

- Gjatë periudhës korrik-shtator 2019, në OMK u anëtarësuan 168 mjekë, ku 155 janë mjekë vendas (duke përfshirë këtu edhe 100 mjekë pa punë dhe 5 mjekë në pension) dhe 13 janë mjekë të huaj.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën korrik-shtator 2019




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri me datën 30.09.2019

2. Mbikëqyrja etiko-profesionale


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të Odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuarra për periudhën T3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën T3	Sanksionet e shqiptuara për periudhën T3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën T3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	5	4	/////	////////	8	2
Këshilli etik	4	9	2 - Gjobë: gjithsej 2,000.00 € Rekomandim kolegial – 2 Qortime publike -3 900 € shpenzime paushallë të procedurës – 5 procedura	Gjobë 1,000.00 € Shpenzime të procedurës – 200.00 € Qortim Publik - 2	5	2
Gjyqi i Nderit	3	3	Sipas ankesës janë vërtetuar vendimet e Këshillit Etik: Gjobë 1,000.00 € Qortim Publik 1 Rekomandim kolegial- 1 500 € shpenzime paushallë të procedurës	/////	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	40	40	/////	/////	/////	/////

Në shqyrtime të drejtpërdrejta, janë mbajtur gjithsej 2 seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në procedurën e mjetit juridik, pranë Gjyqit të Nderit, në seancë të mbyllur janë mbajtur gjithsej 3 mbledhje në të cilat është vendosur për mjetet e parashtruara juridike lidhur me çështjet etiko-profesionale të zhvilluara në shkallë të parë pranë Këshillit Etik.


3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës korrik-shtator, ka akredituar 24 aktivitete.



4. Licencimet

Komisioni për Licensim dhe Rilicensim gjatë tremujorit e tretë të vitit 2019, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun më poshtë:



Nga data e bartjes së kompetencës për licensim, ky Komision i ka lëshuar gjithsej 1383 licenca.

Komisioni për Licensim i OMK-së bazuar në Rregulloren për Regjistrimin, Licensimin dhe Rilicensimin e mjekëve, saktësisht Nenin 14, paragrafi 1 dhe 2, në

tremujorin e tretë të 2019 ka shqiptuar gjithsej tridhjetë (30) gjoba ndëshkuese për vonesë në anëtarësim në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë euro (150€).

5. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

6. Raporti financiar

6.1 Gjendja financiare – 30shtator2019

1.0 Të hyrat:	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3
1.1 Të hyrat e shtyra nga 2018	€143,234.25		
Të hyrat e shtyra nga 2018	€143,234.25		
1.1 Të hyrat nga TM1			
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€245,993.88	€62,293.94	€22,175.00
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jokosovarë	€9,750.00	€4,330.00	€2,500.00
1.1.4 Licencimi	€11,367.65	€9,990.00	€10,540.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€23,194.52	€23,088.00	€39,531.35
Të hyrat nga TM	€290,306.05	€99,701.94	€74,746.35
Të hyrat e shtyra nga 2018			€143,234.25
TOTAL TË HYRAT			€607,988.59

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	€18,199.83	€24,582.83	€24,220.98
2.2 Mëditjet	€14,260.90	€11,492.94	€9,064.10
2.3 Material shpenzues	€1,335.98	€659.75	€1,349.57
2.4 Reprerentacioni	€234.21	€258.80	€332.57
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€5,473.25	€8,448.18	€9,400.00
2.6 Shpenzimet e tjera*	€35,996.02	€20,254.01	€10,020.73
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€3,000.00	€0.00	€2,500.00
TOTAL SHPENZIMET	€78,500.19	€65,696.51	€56,887.95
TOTAL SHPENZIMET			€201,084.65

TOTAL BILANCI	€406,903.94
----------------------	--------------------

1.1.5*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimil, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatë për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhura të tjera

2.6 *Faksimil, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës ka dhënë përkrahje financiare për Edukim të Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të tretë:

- Për Shoqatën e Onkologëve të Kosovës në vlerë prej 2,000.00 €.
- Për Kongresin e Shoqatës së Ortopedëve të Kosovës në vlerë prej 1,800.00€.
- Për Kongresin e Shoqatës së sëmundjeve të rralla në bashkëpunim me Klinikën e Pediatriisë në vlerë prej 2,000.00€.
- Për Shërbimi profesional të shëndetit mendor të Kosovës në vlerë prej 1,600.00€.
- Për Shoqatën e Oftamologëve në vlerë prej 2,000.00€

Prokurimi

Gjatë tremujorit të tretë të këtij viti u zhvilluan dy procedura prokurimit:

- Procedura njëburimore e prokurimit për vendin e mbajtjes së Kongresit dhe Panairit të Parë Mjekësorë-"Hotel Emerald"
- Procedurë e hapur e prokurimit për: Kontratë për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e parë mjekësor-CEO Shpk

7. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore korrik – shtator 2019, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tre (5) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T3	Vendimet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën T3	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën T3	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	27	22	5	<p>1-Aprovimi i propozimit që përmes procedurave të vogla zgjidhet ekipi për mbarëvajtje të Kongresit dhe Panairit të I-rë Mjekësor;</p> <p>2-Pezullimi i masave të shqiptimit të gjobave administrative;</p> <p>3-Për publikimin e njoftimit për rekrutim të stafit të OMK-së;</p> <p>4-Formimi i komisionit për hapjen e ofertave për ndërtimin e</p>	///

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T3	Vendimet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën T3	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën T3	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
				<p>stendave për Kongresin dhe Panairin e I-rë Mjekësor;</p> <p>5-Formimi i komisionit për përgatitjen e specifikave për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e I-rë Mjekësor;</p> <p>6-Formimi i komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e I-rë Mjekësor;</p> <p>7-Përzgjedhja e Hotel Emerald si ofrues i shërbimeve për Kongresin dhe Panairin e I-rë Mjekësor;</p> <p>8-Përcaktimin e llojit të dekoratave dhe mirënjohjeve dhe themelimin e Këshillit Ad-Hoc;</p> <p>9- Emërimi i dr. Faik Shatri si përfaqësues në hartimin e protokolleve Klinike;</p> <p>10- Aprovimi i fillimit të procedurave të prokurimit të hapur për Auditim 2019;</p> <p>11- Vendim për “ISBN”</p> <p>12- Aprovimi i propozimit për mbarëvajtjen e ueb faqes lidhur me Kongresin dhe Panairin e I-rë Mjekësor;</p> <p>13- Për ndarjen e mjeteve financiare për pesë punime shkencore;</p>	

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore korrik – shtator 2019, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar një (1) kërkesë për leje hulumtimi.

Kërkesa e shqyrtuar është aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikuesit i është lëshuar leja për hulumtim.

Gjithashtu, Komisioni gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe një vendim për leje-hulumtim si lëndë e bartur nga tremujori i dytë 2019.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së:

Në periudhën kohore korrik – shtator 2019, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar dy (2) kërkesa për përkrahje financiare. Njëra nga këto dy kërkesa është aprovuar ndërsa për të dytën është nxjerrë Vendim për refuzim të mbështetjes financiare.

10. Aktivitete të tjera

10.1 Shërbimi profesional

Me datën 11 shtator 2019, është bërë përzgjedhja për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zyrtar/e të Financave dhe Marketingut sipas konkursit të publik të datës 17 gusht 2019.

10.2 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë

Me datë 1 korrik është hapur forma e regjistrimit për pjesëmarrës në Kongresin dhe Panairin e Parë Mjekësor që do të mbahet me 18-19 tetor 2019, në Hotel Emerald në Prishtinë, ku deri me datën 30 shtator janë regjistruar mbi 1800 pjesëmarrës. Në kuadër të pjesëmarrësve janë të përfshirë edhe fizioterapeutët pasi që Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës kanë nënshkruar shkresë mirëkuptimi ku OFTK do t'i njohë pikët kredituese të gjithë pjesëmarrësve Fizioterapeutë në Kongresin dhe Panairin e parë mjekësor.

Në këtë aktivitet pritet të ketë deri në 2000 pjesëmarrës, dhe përveç ligjëratave gjatë kongresit gjithashtu do të organizohen katër Punëtori me temat:

- Menaxhimi i avancuar i rrugëve ajrore/Menaxhimi i rrugëve ajrore në Trauma
- Diagnostika e avancuar në pacemaker dhe ICD
- Këshillimi virtual për kontrceptiv.
- Uveitet

Këshilli Shkencor ka vlerësuar dhe përzgjedhur 75 abstrakte të punimeve për prezantim dhe quickshot. Gjatë ditës së parë të kongresit me datë 18 tetor 2019 do të mbahen sesionet e lëmive Kirurgjikale, kurse me datë 19 tetor 2019 do të mbahen sesionet e lëmive Internistikë dhe Diagnostikë.

Brenda afatit për aplikim për sponsorizim të Kongresit dhe Panairit Mjekësor kanë dorëzuar ofertat disa kompani ku kompania Layo është shpallur sponsor Gold, YessPharma dhe Italmed sponsor të argjendtë, përzgjedhja është bërë sipas ofertave më të larta. Gjithashtu 20 kompani dhe organizata kanë shprehur interesim për pjesëmarrje si ekspozues në Panairin Mjekësor.

Për promovimin e Kongresit dhe Panairit Mjekësor, OMK dhe Gazeta Shneta kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Në këtë memorandum është paraparë që Gazeta Shneta të ndihmojë OMK-në si bartëse e organizimit të Kongresit dhe Panairit, përmes infrastrukturës mediale në kuadër të veprimtarisë gazetareske.

Donatorët të cilët kanë shprehur gatishmërinë për të përkrahur këtë aktivitet:

- AQH në vlerë prej 7,000.00 Euro
- Lux Dev përmes projektit KSV/017 në vlerë prej 3,000.00 Euro
- UNFPA në vlerë prej 3,000.00 Euro

10.3 Auditimi financiar dhe funksional

Me datë 14 gusht 2019 ka përfunduar auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2018. Auditimi financiar dhe funksional përfshinë Raportin e auditorëve të pavarur, Pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e pozitës financiare, Pasqyra e ndryshimeve në fonde, Pasqyra e rrjedhës së parasë dhe shënimet e pasqyrave financiare

10.4 Marrëveshjet

- Oda e Mjekëve të Kosovës në muajin gusht të këtij viti ka lidhur Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Grave “Medica Gjakova” me qëllim të:
 - Implementimit të projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj traumave për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale” i cili synon forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale dhe implementohet në dy komuna në atë të Gjakovës dhe Prizrenit.
- Me 13 gusht 2019, Odat e profesionistëve shëndetësor në Kosovë kanë nënshkruar kontratë të përbashkët, mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e objektit, për nevojat e ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve publike të përcaktuara me ligj.

Ndërtimi i objektit pritet të përkrahet nga Agjencia për Bashkëpunim të Luksemburgut përmes projektit “Health Support Programme in Kosovo Phase II-KSV/017”.

10.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësisë individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo dhe civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik-shtator	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën korrik-shtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrik-shtator	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	2	2	///	1	///

10.6 Marrëdhënie ndërkombëtare

- Oda e Mjekëve të Kosovës merr pjesë në Simpoziumin e 26-të të ZEVA-s
 - Oda e Mjekëve të Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari dhe Nënkyetari i OMK-së Dr. Pleurat Sejdiu dhe Dr. Naser Gjonbalaj, merr pjesë në Simpoziumin e 26-të të ZEVA-s (Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore). Simpoziumi i Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore (ZEVA) është një takim i përvitshëm i cili siguron një forum për përfaqësuesit e odave të mjekëve nga rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore për të përmbushur dhe diskutuar çështje që shqetësojnë reciprokisht.
 - Ambasada e Kosovës në Hungari organizoj takim me përfaqësues të OMK-së
 - Ambasadorët e Kosovës dhe Shqipërisë në Hungari organizuan takim me Kryetarin dhe Nënkyetarin e OMK-së Dr. Pleurat Sejdiu dhe Dr. Naser Gjonbalaj, ku të pranishëm

në këtë takim ishin edhe studentë shqiptarë të cilët studiojnë në Hungari.

Kryetari i OMK-së morri pjesë në takimin vjetor të forumit evropian të shoqatave mjekësore (EFMA)

- Me datë 29 gusht, Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës Dr. Pleurat Sejdiu morri pjesë në takimin vjetor të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore. Kryetarit Sejdiu i është bërë ftesë nga Oda e Mjekëve të Malit të Zi e cila edhe është organizatore e takimit të sivjetshëm.

11. Plani i veprimit për 2019

10.1 Projektet afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/databazë interaktive, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së, është mbajtur një workshop dy ditorë me dy ekspertë të IT-së dhe stafin e OMK-së ku është punuar për të identifikuar specifikacionet e databazës. Edhe një workshop është planifikuar për muajin nëntor, ku do të validohen të gjitha proceset e punës dhe specifikacionet në bazë të të cilave do të shpallet tenderi për databazë nga projekti KSV/017.

10.2 Aktivitetet kyçe për T4/2019

- Organizimi i Kongresit dhe Panairit të parë të Mjekësisë
- Rishqyrtimi i rregulloreve dhe rekomandime për ndryshime gjatë Tryezës së rrumbullakët/punëtorisë ku do të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisioneve dhe këshillave të OMK-së
- Përpilimi i buxhetit për vitin 2020
- Mbajtja e takimit të Kuvendit të OMK-së
- Raportime vjetore

- Shpallja e tenderit per auditim financiar për vitin 2019, 2020 dhe 2021
- Zbërthimi i kompetencave për edukimin specialistik bazuar në ligjin për OPSH-të;